



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Java XI&XII

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

|

VLERËSIMI & KONTROLLI I PROJEKTIT

- ▶ **Monitorimi i projektit dhe kontrolli**
- ▶ Ciklet e kontrollit; Projektimi i sistemit të monitorimit;
- ▶ Monitorimi i performancës së projektit



Menaxhimi i Projekteve; VLERËSIMI & KONTROLLI I PROJEKTIT

Monitorimi i projektit dhe kontrolli

Ciklet e kontrollit; Projektimi i sistemit të monitorimit;
Monitorimi i performancës së projektit.

VLERËSIMI & KONTROLLI I PROJEKTIT

CIKLET E KONTROLLIT- MODELI I PËRGJITHSHËM

- ▶ Gjatë gjithë kohës është vënë në dukje nevoja për të planifikuar, kontrolluar progresin, krahasuar progresin me planin dhe për të marrë veprimet e duhura korigjuesë nëse progresi nuk përshtatet me planin.
- ▶ Aspektet kryesore që duhet të planifikohen, monitorohen dhe kontrollohen janë koha, kosto(buxheti) dhe performanca (specifikimet). Këto përbëjnë edhe objektivat kryesore të projektit.

CIKLET E KONTROLLIT- MODELI I PËRGJITHSHËM

Modeli I përgjithshëm I kontrollit të organizatës përfshin katër komponentë që operojnë në një cikël të vazhdueshëm dhe mund të paraqiten në formën e një rrethi të mbyllur. Këto elementë janë:

1. Përcaktimi I qëllimit të projektit ndërtohet mbi bazën e një proçesi të kujdesshëm bazuar në Strukturën e Zbërthimit të Punës. Kuptojmë që SZP përcakton të gjitha detyrat dhe paketat e punës që lidhen me projektin, cakton personelin përgjegjës për to dhe krijon një grafik vizual të projektit nga niveli më i lartë deri tek nivelet e detyrës dhe nëndetyrës.
2. Matja e progresit. Manaxherët e projektit duhet të kenë një sistem që do ti lejojë atë të masin statusin në vazhdimësi të aktiviteteve të ndryshme të projektit në kohë reale.

CIKLET E KONTROLLIT- MODELI I PËRGJITHSHËM

3. Krahasimi i performancës aktuale me atë të planifikuar. Mbasi e kemi të qartë planin bazë të projektit dhe njohim metodën e matjes me saktësi të progresit, hapi tjetër është të krahasohen dy pjesët e informacionit. Analiza e boshllëkut ndërmjet këtyre dy performancave shërben si bazë për testimin e statusit të projektit.

4. Marrja e veprimeve korigjuese. Mbasi janë konstatuar devijime të konsiderueshme nga plani i projektit, është e nevojshme angazhimi në veprimet korigjuese për të minimizuar apo hequr këto devijime. Mbas veprimit korigjues, cikli i monitorimit dhe kontrollit fillestar fillon përsëri.

CIKLET E KONTROLLIT- MODELI I PËRGJITHSHËM

Cikli I kontrollit është I vazhdueshëm. Ndërkohë që krijohet plani, niset me matjen e progresit dhe fazat krahasohen kundrejt planit bazë.

Çdo indikacioni devijimi të konsiderueshme nga plani duhet ti jepet përgjigja e duhur menjëherë, gjë që çon në rikonfigurim të planit, në rivlerësim të progresit e kështu me rradhë.

Monitorimi I projektit është I vazhdueshëm, një cikël me kohë të plotë për përcaktimin e qëllimit, vlerësimin, korregjimin, përmirësimin dhe rivlerësimin.

PROJEKTIMI I SISTEMIT TË MONITORIMIT

- ▶ Hapi I parë për ngritjen e një sistemi monitorimi është identifikimi i faktorëve kryesorë që do të kontrollohen.
- ▶ Duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë se cilat karakteristika specifike të performancës, kostos dhe kohës duhet të kontrollohen dhe më pas të përcaktohen kufijtë ekzakt brenda të cilëve duhet të ruhet e bëhet kontrolli.

INFORMACIONI QË NEVOJITET DHE RAPORTIMI

- ▶ Përdorimi i gjerë i softuerit e ka bërë procesin e grumbullimit dhe shpërndarjes së informacionit shumë më shpejtë dhe shumë më pak të vështirë se më parë.

PROCESI I RAPORTIMIT

- ▶ Përveç kriterit që raportet duhet të jenë në dispozicion në kohë që të përdoren për kontrollin e projektit, periudha kohore e raportimeve duhet t'i korrespondojë në përgjithësi kohëve të momenteve kritike të projektit.
- ▶ Kjo do të thotë që raportet e projektit nuk duhet të lëshohen në mënyrë periodike – me përjashtim të raporteve të progresit për menaxhimin e lartë. Përgjithësisht raportet duhet të skedulohen në planin e projektit.
- ▶ Ato duhet të lëshohen në kohë.

PROBLEMET E ZAKONSHME TË RAPORTIMIT

- ▶ Mesazhi real që nxirret nga raportet e projektit është krahasimi i aktivitetit aktual me planin dhe i outputit aktual me outputin e dëshiruar. Variacionet raportohen nga sistemet e monitorimit dhe përgjegjësia për veprimet e duhura mbetet tek kontrollori. Meqenëse plani i projektit jepet në lidhje me qëllimin, kohën dhe koston, variacionet raportohen për të njëjtat variabla.



Menaxhimi i Projekteve;

VLERËSIMI & PËRFUNDIMI I PROJEKTIT

Përfundimi i projektit

Procesi i vlerësimit të projektit; Mësimet e nxjerra;

Auditimi i projektit; raporti i auditimit; kushtet kryesore për vlerësimin/auditimin e projektit; tipet e përfundimit të projektit;

VLERËSIMI & PËRFUNDIMI I PROJEKTIT

- ▶ Vlerësimi I projektit vlerëson progresin dhe përformancën e projektit duke e krahasuar me përformancën dhe progresin e planifikuar të projektit, ose duke e krahasuar me progresin dhe përformancën e projekteve të tjera të ngjashme.
- ▶ Vlerësimi I projektit duhet të jetë I besueshëm në sytë e grupit të menaxhimit dhe grupit të projektit për të cilët ai është bërë. Kështu që vlerësimi duhet të bëhet po me aq kujdes sa edhe vetë projekti.

VLERËSIMI & PËRFUNDIMI I PROJEKTIT

Tre janë rezultatet kryesore nga mbyllja e projektit:

- 1. Përfundimi I projektit.** Detyra kryesore e përfundimit të projektit është të sigurojë që projekti është aprovuar dhe miratuar nga klienti. Aktivitetet të tjera për përfundimin përfshijnë mbylljen e llogarive, pagesën e faturave, ricaktimin e pajisjeve dhe personelit, gjetjen e mundësive të reja për stafin e projektit dhe raporti final.
- 2. Vlerësimi I performancës dhe menaxhimit të projektit.** Vlerësimi përfshin performancën e grupit, të antarëve individualë të grupit dhe të menaxherit të projektit.
- 3. Retrospektiva.** Nxerrja e mësimëve nga e kaluara konsiderohet si një referencë e mirë për përmirësimin e performancës së projekteve aktuale dhe atyre në të ardhmen

QËLLIMET E VLERËSIMIT

- ▶ Sigurisht që elementi kryesor i vlerësimit të projektit është “suksesi” i tij.
- ▶ Në një studim të projekteve të llojeve dhe përmasave të ndryshme (Shenhar 2000), 127 menaxherë projektsh kanë identifikuar 13 faktorë që përbëjnë katër dimensionet e pamvarura të suksesit të projektit, nën këndvështrimin e tyre si menaxherë projekti.

QËLLIMET E VLERËSIMIT

- ▶ **Dimensioni I parë** më kryesor është efienca e projektit në përmbushjen si të afatit ashtu edhe të buxhetit.
- ▶ **Dimensioni I dytë** dhe më kompleks është ai i **impaktit tek klienti/kënaqjes**. Dimensioni I tretë është suksesi I biznesit, që matet kryesisht në lidhje me suksesin komercial dhe pjesën e tregut.
- ▶ **Dimensioni I fundit**, deri diku më I vështirë për tu siguruar është potenciali në të ardhmen. Ky përfshin faktorët që lidhen me hapjen e tregjeve të reja, zhvillimin e linjave të reja të produkteve dhe shërbimeve ose në rastin e një projekti të brëndëshëm, zhvillimin e teknologjisë së re, të aftësive apo të kopetencave.

AUDITIMI PROJEKTIT

- ▶ Auditimi I projektit është një ekzaminim I tërë I menaxhimit të projektit, I metodologjisë dhe procedurave të tij, I rekordeve, buxheteve dhe shpenzimeve dhe I shkallës së përfundimit. Ai mund të lidhet me projektin si një I tërë ose me pjesë të projektit.
- ▶ Duhet vënë në dukje që auditimi I projektit nuk është auditim financiar.



	Auditi financiar	Auditi I projektit
Statusi	Konfirmon statusin e biznesit në lidhje me standartin e pranuar	Duhet krijuar bazat dhe duhet konfirmuar statusi për çdo projekt Statusi në të ardhmen I projektit
Deklarimet	Gjendja ekonomike e kompanisë	Në terma financiarë plus skeduli, progresi, prdorimi I burimeve, plus statusi I qëllimeve shtesë
Vlerësimi	Kryesisht në terma financiare	
Sistemi I mbajtjes së rekordeve	Formati diktohet nga rregullat ligjore dhe standartet profesionale	Jo sistem standart, përdoret çdo sistem I dëshiruar nga organizatat individuale ose të diktuar nga kontrata
Ekzistenca e sistemit të informacionit	Regjistrime minimale nevojiten për të nisur auditim	Nuk ekzistojnë rekorde, të dhënat duhet të projektohen dhe përdoren për të nisur auditimin
Rekomandimet	Zakonisht pas ose asnjë, shpesh të ndalur vetëm për menaxhimin dhe sistemin e kontabilitetit	Shpesh të kërkuara, mund të mbulojnë një aspekt të projektit ose menaxhimin e tij
Kualifikimet për raportin e auditimit	Zkonisht për të kualifikuar bilancet nëse kushtet diktojnë, por presioni I fortë menaxherial për të mos bërë kështu	Klualifikimet fokusohen në mangësitë e procesit të auditimit (p.sh, mungesa e ekspertizës teknike, mungesa e fondeve ose kohës)

PËRFUNDIMI NATYRAL- PROÇESI I MBYLLJES

- ▶ Proçesi I mbylljes së projektit mbetet kompleks duke përfshirë shumë aktivitete që duhet të ndodhin gjatë një periudhe kohe të përcaktuar. Le ti konsiderojmë këto aktivitete dhe hapat e nevojshme për ti përfunduar ato sipas renditjes.



PËRFUNDIMI I PUNËS

- ▶ Sfida e menaxherit të projektit është që ta mbajë grupin të angazhuar për të kryer këto aktivitete finale.
- ▶ Një proces i rregullt i përfundimit të detyrave finale zakonisht kërkon përdorimin e listës së kontrollit si një mjet kontrolli.



DORËZIMI I PROJEKTIT

- ▶ Mund të jetë një proces kompleks në varësi të kushteve kontraktuale, të klientit (të brendshme apo të jashtëm), kushteve të mjedisit dhe faktorëve të tjerë.
- ▶ Transferimi nuk përfshin vetëm kalimin e pronësisë së projektit tek përdoruesit por kërkon gjithashtu ndërtimin e programeve të trajtimit për përdoruesit, transferimin dhe shkëmbimin e projekteve teknike, vënien në dispozicion të gjitha vizatimeve dhe specifikimeve inxhinierike, etj.

ARRITJA E PRANIMIT NGA KLIENTI

- ▶ Pranimi nga klienti si një ndër faktorët kritikë të suksesit paraqet një ndër përcaktuesit e rëndësishëm nëse projekti është ose jo i suksesshëm.
- ▶ Meqenëse ky proces mund të jetë i komplikuar, duhet që të fillohet planifikimi më përpara si për transferimin e produktit final tek klienti ashtu edhe për krijimin e një programi për të lehtësuar kalimin e pronësisë.

MARRJA E PËRFITIMEVE

Projektet iniciohen për të zgjidhur probleme e për ti shërbyer ndonjë qëllimi specifik apo një tërësie qëllimesh. Përfitimet duhet të përcaktohen lehtësisht.

Për shembull një sistem i vlerësimit të projektit duhet të masë:

1. Kriteret më të cilat përfitimet e produktit apo të shërbimit do të maten.
2. Momentet e kohës në të cilat matja apo vlerësimi do të bëhet.
3. Individin e cili e pranon përgjegjësinë për të bërë matjen apo vlerësimin në një mënyrë që bihet dakord dhe për momente kohe të rëna dakord.

ANALIZA SE SI KA SHKUAR PUNA

- ▶ Një nga elementët më të rëndësishme në mbylljen e projektit përfshin bërjen e një analize të thellë për të nxjerrë mësimet, duke u bazuar në një shqyrtim realist dhe kritik të projektit- momentet më të mira dhe më të dobëta, vështirësitë e parashikuara dhe sugjerimet për projektet e ardhshme.

DOKUMENTIMI


- ▶ Përfundimi I projektit përfshin një mori të konsiderueshme shkresash të nevojshme për të dokumentuar dhe regjistruar proceset, për të mbyllur llogaritë e burimeve dhe kur është e nevojshme për të ndjekur termat dhe kushtet ligjore të marrëveshjes kontraktuale. Disa nga elementët më të rëndësishëm të kësaj faze përfshijnë:

DOKUMENTIMI

1. **Dokumentacioni.** Të gjithë regjistrimet e projektit duhet të arkivohen. Këto regjistrime përfshijnë afatin kohor dhe dokumentat e planifikimit, të gjitha materialet e monitorimit dhe kontrollit, çdo regjistrim për përdorim materialesh ose burimi tjetër, kërkesat për ndryshimin e pronësisë së klientit, aprovimin e ndryshimit të specifikimeve, etj.
2. **Dokumentat ligjor.** Të gjitha dokumentat kontraktual duhet të regjistrohen dhe arkivohen.
3. **Dokumentat kosto.** Të gjitha regjistrimet kontabile duhet të mbyllen me kujdes, duke përfshirë regjistrimet për kontabilitetin e kostos, listen e materialeve dhe burimeve të tjera të përdorura.
4. **Personeli.** Kosto dhe pagesat e tjera për personelin e grupit të projektit duhet të llogariten.

SHPËRNDARJA E GRUPIT

- ▶ Shpërndarja e grupit të projektit mund të jetë ose një proces tepër informal (mbajtja e një mbrëmje finale) ose një proces shumë i strukturuar (bërja e vlerësimeve dhe analiza të detajuara të performancës dhe punës për të gjithë anëtarët e grupit).



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com